



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Gramsh më 13 /10 / 2023

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 13.10.2023

Drejtuar: Operatorit Ekonomik : "INERTI " Sh.p.k me adresë :Gramsh, Lagjia "Sporti"

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 78115-08-23-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: " Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi"

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : Buletini Nr. 73 datë 28.08.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE)

- " ASI-2A CO "	Sh.p.k	K53002402C
- " 2 Z KONSTRUKSION"	Sh.p.k	J63229466K
- " FLED "	Sh.p.k	K17621104C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 50 399 015 (pesëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, pa TVSH.

2.OE " INERTI " Sh.p.k

J66926804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 66 666 732 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë, pa TVSH.

3.OE " PEPA GROUP " Sh.p.k

L42215009L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 54 033 062 (pesëdhjetë e katër milion e tridhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e dy)lekë, pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE)

- " ED KONSTRUKSION " Sh.p.k

K61625001I

- " LIS KONSTRUKSION" Sh.p.k

K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 58 457 336,50 (pesëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë presje pesë) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE)

- " ASI-2A CO " Sh.p.k

K53002402C

- " 2 Z KONSTRUKSION" Sh.p.k

J63229466K

- " FLED " Sh.p.k

K17621104C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

për arsyet e mëposhtme:

- Referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.09.2023 dhe ndarjes së punimeve “2 Z Konstruksion”shpk tek Seksioni “Punime suvatimi “ nuk ka parashikuar marrjen përsipër të kryerjes së punimeve për Veshje fasade me polisterol komplet jeshil t=5 cm ==+rrjetë +suva, ndërkohë që në Listën e cmimeve sipas zërave të preventivit ka parashikuar kryerjen e punimeve për këtë zë në masën 1530m², në vlerën 3 213 000 lekë, në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit.
- Referuar Listës së cmimeve sipas zërave të preventivit , OE ”ASI-2A CO” shpk ka marrë përsipër të kryejë punimet në zërat e punimeve tek Seksioni “Ambienti teknik i

furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar” dhe “Ambienti teknik i impiantit të ngrohjes” si më poshtë:

	Ambienti teknik i furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar		
2.494/5	F.V. Valvol nderprerese DN 50 (Ø 2")	cope	2.0
2.494/4	F.V. Valvol nderprerese DN 40 (Ø 1 1/2")	cope	16.0
2.494/3	F.V. Valvol nderprerese DN 32 (Ø 1 1/4")	cope	1.0
An	F.V. Valvol moskthimi DN 40 (Ø 1 1/2") Pn 16 bar	cope	1.0
An	F.V. Filter DN 40, Ø 1 1/2"	cope	1.0
An	F.V. Reduktor presioni Ø 1 1/2"	cope	1.0
An	F.V. Xhunto antivibruese DN 50 Ø 2"	cope	2.0
An	F.V. Xhunto antivibruese DN 40 Ø 1 1/2"	cope	2.0
An	F.V. Mates uji 1 1/2"	cope	1.0
An	F.V. Galexhant mekanik 1 1/2"	cope	2.0
An	F.V. Galexhant elektrik	cope	1.0
	F.V. Elemente plotsues per instalimet e linjave hidraulike (Niple, Manikota, Hollandez, Fije lini, Paste, Loctide leng, etj)	kg	22.0
	Ambienti teknik i impiantit të ngrohjes		
2.493/1	F.V. Kanal i tymrave me llamarine çeliku, me shtrese izioluese 400/450 mm .	kg	700.0

Ndërkohë referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.09.2023 nënshkruar nga 3 anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe ndarjes së punimeve, asnjë nga të tre anëtarët nuk ka marrë përsipër kryerjen e këtyre punimeve, sipas zërave më sipër. Kryerja e këtyre punimeve nga “OE”ASI-2A CO” shpk, bie ndesh me marrëveshjen e nënshkruar nga 3 anëtarët e BOE-s.

- Referuar Listën e cmimeve sipas zërave të preventivit , OE”ASI-2A CO” shpk ka marrë përsipër të kryejë punimet në zërat e punimeve tek Seksioni “Punime prishje ” Ngarkim transport auto mbeturina-5 km, ndërkohë referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.09.2023 nënshkruar nga 3 anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe ndarjes së punimeve, asnjë nga të tre anëtarët nuk ka marrë përsipër kryerjen e transportit të mbeturinave. Kryerja e këtyre punimeve nga “OE”ASI-2A CO” shpk bie ndesh me marrëveshjen e nënshkruar nga 3 anëtarët e BOE-s.
- Referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.09.2023 nenit 2 të saj “Deklarim specifik”, Palët që kanë nënshkruar marrëveshjen kanë deformuar objektin e prokurimit dhe fondin limit , konkretisht kanë deklaruar “ *Palet deklarojne se bashkimi i Operatoreve Ekonomike do te behet vetem per tenderin e cituar me siper me Autoritet Kontraktor " Bashkia Gramsh "*, me objekt: “ *Rikonstruksioni i Gjimnazit "Shefqet Guzi", Rikonstruksion i godinës së Qendrës Stërvitore dhe infrastrukturës së saj mbështetëse” me fond limit 56.888.709(pesedhjetë e gjashtë milion e teteqind e tetedhjetë e tete mije e shtateqind e nente) leke pa tvsh*”. Ndërkohë fondi limit është 67,162,656 lekë, pa TVSH.

- Anëtari i BOE “2 Z Konstruksion” shpk, nuk ka dorëzuar vërtetim për xhiron vjetore në kundërshtim me neni 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,(i ndryshuar), dhe pikën 2.2.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit,të përcaktuara në DST.
- Anëtari i BOE “ Fled” shpk ka detyrime të palikuiduara ndaj Bashkisë Gramsh , bazuar në Raportin Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.205/9 datë 31.07.2023, në masën $264\ 970 \times 70\% = 185\ 479$ lekë , si dëm ekonomik ndaj bashkisë Gramsh si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për kontratën nr.1931 prot dt.28.05.2021 me objekt “Sistemim –asfaltim lagjia “ish-Reparti Ushtarak”, ku në cilësinë e anëtarit të BOE ka marrë përsipër të kryejë 70 % të punimeve .
- Në pikën 2.3.9 të Kriterëve të kualifikimit është kërkuar Certifikatë “ISO 3834-2005, (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike) ose ekuivalente”. Për plotësimin e këtij kriteri vetëm njëri prej anëtarëve”ASI-2A CO” shpk ka dorëzuar certifikatën nr.007/23, ISO 3834-4-2021, e cila është e parregullt pasi i mungon logo e trupave akredituese IAF dhe ESYD sic e përmbajnë certifikata e tjera ISO të lëshuara nga ky organ akreditues të dorëzuara nga ky operator ekonomik në SPE. Kështu që ky BOE nuk përmbush kriterin për certifikatën “ISO 3834-2005, (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike)
- Me shkresën nr.3287 datë 29.08.2023 të KVO-së i është kërkuar Bashkisë Roskovec kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit , konkretisht shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimi “ per dy procedura prokurimi ku është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratën OE” 2Z Konstruksion” shpk, konkretisht procedurat me objekt “ Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e bashkisë Roskovec “, dhe “Rikonstruksion I shkollës “Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme”. Nga informacioni i dërguar në rrugë elektronike nga Bashkia Roskovec, formularët përmbledhës të vetëdeklarimit për të dy objektet e cituar më sipër konstatohet se: Mjeti me targa AA217JY”Autobot uji” me nr.shasie WDB67601215255430 është deklaruar në procedurën objekt vlerësimi nga dy anëtarët e ”ASI-2A CO” shpk & “2 Z Konstruksion”shpk, është marrë me qira në të njëjtën periudhë nga të dy anëtarët e BOE- s janë deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme”. Nga të dy anëtarët e BOE është deklaruar se të gjitha mjetet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fituese.Ndërkohë anëtari tjetër’Fled” shpk nuk ka deklaruar asnjë autobot uji.Sa më sipër ky BOE nuk përmbush kriterin për një autobot uji.

Njëkohësisht mjetet e deklaruara nga OE” 2Z Konstruksion” shpk në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht mjetet në pronësi: Eskavator me goma me targa AJMT05 me nr. shasie KMTPW021K79 H55255, kamioncin me vinc me targa FR6168D me nr. shasie WDB9044121P7 11396 dhe mjetet e marra me qera: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targa AA015ZX me nr. shasie WMAT46ZZZYM283715, Kamioncine me kapacitet mbajtës3-5 ton me targa AA393DG me nr. shasie WDB67703515435209, Kamioncine me kapacitet mbajtës1- 3ton me targa FR4370D me nr. shasie VF152AFA129237133, Kamion me vinc me targa AA594CY me nr. shasie WDB65600515561332 janë deklaruar në kontratën me bashkinë Roskovec

“Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e bashkisë Roskovec” dhe “Rikonstruksion i shkollës “Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme”.

OE” 2Z Konstruksion” shpk ka deklaruar gjithashtu se i gjithë stafi teknik prej 23 vetësh i deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike ndërkohë që KVO konstaton se ing.ndërtimit K.D, eksperti zjarrfikës E.Z, tekniku ndërtimit RR.P,mekaniku E.P,muratori/suvatues M.Z, specialist i punimeve të gipsit F.Z, janë deklaruar në të dy kontratat e mësipërme të bashkisë Roskovec me objekt “ Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e bashkisë Roskovec “, dhe “Rikonstruksion i shkollës “Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme.

Ing.elektrik, F.Z,ing.hidroteknik Th.G, karpentieri Xh.T, specialist i gipsit L.C janë deklaruar në kontratën me bashkinë Roskovec “ Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e bashkisë Roskovec”.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE)

- " ED KONSTRUKSION " Sh.p.k
- " LIS KONSTRUKSION" Sh.p.k

K61625001I
K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

për arsyet e mëposhtme:

- Preventivi i ndarjes së punimeve nuk është i rregullt pasi nuk është nënshkruar e vulosur nga asnjë anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.Gjithashtu në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit datë 08.09.2023 , anëtari “Lis Konstruksion “ shpk ka marrë përsipër të kryejë 20% të punimeve, referuar vlerës totale të preventivit $58\,457\,336,5 \times 20\% = 11\,691\,467$ lekë vlerë punimesh, ndërkohë referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marrë përsipër vlerën e punimeve në masën $11\,635\,620,5$ lekë,sipas përlllogaritjeve $55\,846,8$ lekë më shumë nga marrëveshja e bashkëpunimit.Po kështu anëtari “Ed Konstruksion” shpk ka marrë përsipër sipas marrëveshjes 80% të punimeve ,që korrespondon në vlerë referuar preventivit të ofertës $58\,457\,336,5 \times 80\% = 46\,765\,869$ lekë, sipas përlllogaritjeve $55\,846,8$ lekë më pak nga marrëveshja e bashkëpunimit.
- Në pikën 2.3.9 të Kritereve të kualifikimit është kërkuar Certifikatë “ISO 3834-2005, (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike) ose ekuivalente”.Të dy anëtarët e BOE për plotësimin e këtij kriteri kanë dorëzuar : “Ed Konstruksion” shpk ka dorëzuar certifikatën EN-ISO-3834-2:2005 nr.AQS/QS/85572022, lëshuar nga AQScert , dhe anëtari “Lis Konstruksion “ shpk ka dorëzuar certifikatën UNI-EN-ISO-3834-2:2006 nr.AQS/QS/75872021, lëshuar nga AQScert, certifikata të cilat nuk mbajnë logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit(DPA) ashtu sic i përmbajnë tre certifikatat e tjera ISO të lëshuara nga AQScert, të kërkuara e të dorëzuara nga këta 2 operatorë ekonomikë në SPE, cka do të thotë se AQScert nuk është akredituar për lëshimin e certifikatës “ISO 3834-2005, (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike).Kështu që ky BOE nuk përmbush kriterin për certifikatë “ISO 3834-2005.

- Nenin 88/3 të VKM –së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit datë 08.09.2023 , anëtari “Ed Konstruksion’ shpk ka marrë përsipër sipas marrëveshjes 80% të punimeve dhe anëtari “Lis Konstruksion “ shpk ka marrë përsipër të kryejë 20% të punimeve.Referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 , asnjë nga anëtarët e BOE nuk ka deklaruar se disponon punonjës /specialist duralumini , në përputhje me përqindjen e marrë përsipër sipas parashikimit ligjor sa më sipër, duke mospërmbushur kështu kriterin për 2(dy)punonjës /specialist duralumini.
- Në pikën 2.3.3. të kriterëve të kualifikimit është kërkuar “Operatorët ekonomike duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,.....për kategoritë ***Punime te pergjithshme ndertimi***(NP-1 A,NP-2 B ,NP-3 C,NP-12 C,***Punime speciale ndertimi***,NS -1 A,NS-2 A ,NS-4 A,NS-12 A,NS-13 A,NS-14 A,NS-18 A.

Anëtari “Lis Konstruksion “ shpk ka nuk disponon kategorinë e licencës NP-12 C , por disponon kategorinë NP-12 A.

- Në pikën 2.3.5. të kriterëve të kualifikimit është kërkuar "Operatorët ekonomike për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) Inxhinier Mekanik, 1 (një) Inxhinier Elektronik.

Për plotësimin e këtij kriteri referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të BOE, vetëm anëtari "Lis Konstruksion' shpk ka deklaruar 1 (një) inxhinier elektronik, Anëtari “ED Konstruksion” i cili sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryejë 80% të punimeve nuk ka të deklaruar asnjë inxhinier elektronik.

Sqarojme se sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve, punimet elektrike dhe eletronike do të kryhen nga të dy OE, rrjedhimisht të dy OE duhet të përmbushin këtë kriter në zbatim të nenin 88/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", parashikohet se "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim,

- Në kriteret e kualifikimit në pikën 2.3.7 janë kërkuar ndër të tjera Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar ne

profilet perkatese si më poshtë: Punonjes /Specialist Gipsi 2 (dy). Për plotësimin e këtij kriteri referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të dy anëtarëve të BOE, vetëm anëtari “Ed Konstruksion” shpk ka deklaruar dy punonjës gipsi S.K dhe L.Z të cilët janë certifikuar nga Qendra e Trajnimeve të Avancuara e cila nuk është akredituar për lëshimin e certifikatave / diplomave për punonjës gipsi. Për këtë arsye ky BOE nuk përmbush kriterin për 2(dy)Punonjes /Specialist Gipsi .

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur nga subjekti mbështetës “O.B.Konstruksion” sh.p.k, në formularin e vetëdeklarimit në pikën 6 të tij ka deklaruar se ka perzgjedhur alternativën (a).

a)“Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër” ndërkohë që opsionet në pikën 6 të formularit plotësohen nga ofertuesi. Në këtë rast subjekti mbështetës nuk dorëzon ofertë e për rrjedhojë nuk duhet të plotësojë asnjë prej opsioneve të sipërpërmendura.

3.OE " PEPA GROUP " Sh.p.k

L42215009L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

për arsyet e mëposhtme:

- Në nenin 82/3 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,(i ndryshuar), “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” parashikohet se “*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;*

Referuar shtojcës 1 “Formular i ofertës” dhe shtojcës 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit” të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatori ekonomik “Pepa Group” sh.p.k, vlera e ofertës është 54,033,062 (pesëdhjetë e kater milion e tridhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë, pa TVSH.

KVO gjatë kontrollit të Listës së cmimeve sipas zërave të preventivit dorëzuar nga “Pepa Group” sh.p.k, konstaton se gjatë mbledhjes se cmimeve totale për çdo zë të punimeve vlera totale e ofertës rezulton 55 504 582 lekë , pa TVSH, ose 1 471 500 lekë më shumë se oferta e paraqitur . 2% i vlerës ekonomike të ofertuar është $54,033,062 \times 2\% = 1\,080\,661$ lekë, pa TVSH. Pra, rezulton se vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; dhe sipas parashikimeve të nenit 82/3 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,(i ndryshuar), kjo ofertë refuzohet.

- Në pikën 2.3.9 të Kriterëve të kualifikimit është kërkuar Certifikatë “ISO 3834-2005, (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike) ose ekuivalente”. OE “Pepa Group” sh.p.k për plotësim e këtij kriteri ka dorëzuar certifikatën ISO-3834-2:2006 nr.003/3834/22, lëshuar nga Carrer Cert Institute , certifikatë e cila nuk mban logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit(DPA)) ashtu sic i përmbajnë tre certifikatat e tjera ISO të lëshuar nga Carrer Cert Institute , të kërkuara e të dorëzuara nga ky operator ekonomik në SPE, cka do të thotë se Carrer Cert Institute nuk është akredituar për lëshimin e certifikatës “ISO 3834-2005, (Për

Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike). Kështu që ky OE nuk përmbush kriterin për certifikatë “ISO 3834-2005 “.

- Në kriteret e kualifikimit në pikën 2.3.7 janë kërkuar ndër të tjera Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjesit specialistë të kualifikuar ne profilet perkatëse si më poshtë: - Teknik Ndërtimi 2 (dy) dhe Teknik Topograf/gjeodet 1 (një). Për plotësimin e këtij kriteri OE “Pepa Group” shpk ka deklaruar E.F(Universiteti Metropolitan) dhe E.Z (Universiteti Politeknik) si teknikë ndërtimi dhe E.Sh.si teknik topograf (Universiteti Politeknik).

Në këtë pikë gjithashtu është kërkuar që të plotësohet edhe tabela lidhur me Institucionin publik/privat leshues i certifikates/diplomes. Pas verifikimit të faqes zyrtare të Universitetit Metropolitan të Tiranës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, këto dy universitete nuk ofrojnë programe studimi profesionale për teknikë ndërtimi, universiteti Metropolitan ofron program studimi profesional për topograf por topografi i deklaruar E.Sh, është deklaruar se është certifikuar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Sa më sipër ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin për Teknik Ndërtimi 2 (dy) dhe Teknik Topograf/gjeodet 1 (një).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE - " INERTI " Sh.p.k me adresë : Gramsh, Lagjia "Sporti", se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 66 666 732 (*gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy*) lekë, pa TVSH. / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*Bashkia Gramsh, Sheshi kamer Dermyshe, BLV 10 Korriku, kati i tretë i godinës, Personi Përgjegjës për Prokurimet*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI I BASHKISË
BESION AJAZI